



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Emri dhe Mbiemri i eks. Shqyrtues dhe nënshkrimi Genc ZOGAJ <i>GZ</i>	Data e autorizimit të ekspertit 23.11.2022	Data e dorëzimit 5.12.2022	Nr. i lëndës: PSH. NR.665/22
---	---	-----------------------------------	-------------------------------------

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 16.11.2022, OE "Fitim R. Bilalli B.I - DardaniX"- Prishtinë, ka ripërseritur ankesën në OSHP kundër njoftimit për anulim të aktivitetit të prokurimit: **"Furnizim me Aparata të Frymarrjes dhe Bombola të Ajërit"** me nr. të prokurimit 21432700-22-3555-1-1-1.; iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – AGJENCIA PER MENAGJIM EMERGJENT.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: kontratë kornizë – shërbim për 3 vite. Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, dhe Ligjin 05/L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Operatori Ekonomik "Fitim R. Bilalli B.I – DardaniX", në cilësinë e palës së interesuar, parashtron ankesën të perseritur pasi supozon se:

Autoriteti Kontraktues në këtë procedurë të prokurimit, ka kërcënuar shkeljen e dispozitave si në vijim:

- Neni 1 i LPP-se
- Neni 6 i LPP-se
- Nenin 7 i LPP-se
- Nenin 59 i LPP-se
- Nenin 60 i LPP-se
- Neni 64 i LPP-se
- Neni 69 i LPP-se
- Neni 72 i LPP-se
- Vendimi i PSH.NR.408/22 i dt. 03.11.2022 dhe Ekspertiza N.408/22 e dt. 19.09.2022

Kronologji:

Me date 03.11.2022 Organi Shqyrtues I Prokurimit nxjerr VENDIMIN me nr. PSH.nr.408/22 duke vendosur sipas ankeses se parashtruar nga operatori ekonomik "Fitim R. Bilalli B.I – DardaniX", për aktivitetin e prokurimit : **"Furnizim me Aparata të Frymarrjes dhe Bombola të Ajërit"**, me numer të prokurimit 21432700-22-3555-1-1-1 që:

1. **Aprovohet** si e bazuar ankesa e Operatorit Ekonomik "Fitim R. Bilalli B.I", Prishtinë, me numer protokollit 408/22 për aktivitetin e prokurimit **"Furnizim me Aparata të Frymarrjes dhe Bombola të Ajërit"**,

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE "Fitim R. Bilalli B.I" - Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit **Furnizim me Aparate të Frymarrjes dhe Bombola të Ajërit** me nr. të prokurimit 21432700-22-3555-1-1-1.; iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – AGJENCIA PER MENAGJIM EMERGJENT.

G-2

inicuar nga autoriteti kontraktues Agjencia per Menaxhim Emergjent (AME).

2. **Anulohet**, vendimi i AK-se, njoftimi për dhenie te kontrates se aktivitetit te prokurimit "Furnizim me Aparata të Frymarrjes dhe Bombola të Ajërit", me numer te prokurimit 21432700-22-3555-1-1-1: dhe lënda kthehet në Ri-vlerësim.

Duke zbatuar këtë vendim të Organit Shqyrtues të Prokurimit, AK bënë rivlerësimin e aktivitetit të prokurimit siç mund të shihet edhe në Raportin e Vlerësimit të Tenderëve i datës 08.11.2022

Ne dosjen tek Lista e plote Standarde per pershtatshmerine e aftesive profesionale të përcaktuara në Dosjën e Tenderit shihet që të pika:

- Pika C: Operatorët ekonomik bashke me oferten duhen te dorezojne katalog per pajisjen, se bashku me nje pershkrim te karakteristikave te pajisjeve, sic kerkohet ne specifikimet teknike(aneks1) nda Dosja e tenderit, po ashtu linkun e katalogut origjinal sipas prodhuesit.
- Ne këtë pike Komisioni ka konstatuar qe OE Fitim R.Bilalli B.I nuk është ne pajtueshmëri për shkak gjithnjë sipas komisionit Operatori ne fjale ka dorëzuar katalogun e prodhuesit por i cili nuk i plotëson specifikimin teknik ne pikat:
 - 1. Maska nuk posedon dy shtresa izolimi
 - 2. Maska nuk posedon konektimin e kërkuar "P" por posedon tjetër lloj konektimi M16.

Mendimi i Ekspertit Shqyrtues:

- Duke marre për bazë këtë kronologji, edhe pse pretendimet ankimore dhe OE ankues janë te njëjtë dhe janë përsëritur konsiderojmë që Autoriteti Kontraktues AGJENCIA PER MENAGJIM EMERGJENT e ka respektuar vendimin me nr.408/22 te Organit Shqyrtues të Prokurimit te datës 03.11.2022 dhe ka kryer ri-vlerësimin e tenderit në fjale pamvaresisht veridiktit përfundimtar. (shih procesverbalin e datës 08.11.2022).

Pretendimet ankimore te parashtruara ne ankesën e deponuar ne OSHP, janë te njëjta dhe të përsëritura.

KRITERET PËR VLERËSIM

RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

- Duke u bazuar në raportin e vlerësimit te datës 08.11.2022 me nr. të brendshëm të lëndës 214-22-05-111, komisioni vlerësues ka konstatuar se për shkak se Operatori "Fitim R. Bilalli"B.I ka dorëzuar katalogun e prodhuesit por i cili nuk i plotëson specifikimin teknik ne pikat:
 - 1. Maska nuk posedon dy shtresa izolimi
 - 2. Maska nuk posedon konektimin e kërkuar "P" por posedon tjetër lloj konektimi M16.

Është konsideruar i papërgjegjshëm. Shih foton si në vijim:

LISTA E PLOTË STANDARDE PËR PËRSHTATSHMËRINË E AFTËSIVE PROFESIONALE TË TENDERËVE

Dokument	N.T.S.H. "M.S. MEDICOM"	Fitim R. Bilalli B.I.
a. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të kenë së paku një (1) referencë për furnizime me aparate të frymërrjes, maska apo të ngjashëm Brenda tri vjetë të shkurtit.	Në pajtim / Nuk është në pajtim Në pajtim	Në pajtim / Nuk është në pajtim Në pajtim
b. Operatorët ekonomikë duhet të dorëzojnë Autorizim nga prodhuesi ose përfaqësuesi - ofleri i tij për shërbime të pajisjeve. Operatorët ekonomikë duhet të deshmojnë se është i autorizuar nga prodhuesi - dileri i autorizuar i prodhuesit për shërbime të pajisjeve me të cilat ofertojnë me fillim dhe mbarim. Të Prokurimit të projektit në fjalë.	Në pajtim	Në pajtim
c. Operatorët ekonomikë duhet të ofrojnë katalog për pajisjet, së bashku me një përshkrim të karakteristikave të pajisjeve, së bashku me specifikimet teknike (Aneksi 1) nga Dosja e tenderit, po ashtu linkun e katalogut origjinal nga prodhuesit.	Në pajtim	I papajtueshëm
d. Operatorët ekonomikë të dorëzojnë mostrën, në Zyrën e Prokurimit të Agjencionit të Menaxhimit Emergjent në pajtueshmëri me specifikat teknike në këtë DT (Aneksi - 1) para afatit të fundit për dorëzimin e tenderit.	Në pajtim	Në pajtim
e. Prodhuesi ose dileri i autorizuar duhet të jetë i certifikuar me standardin ISO 9001: 2015	Në pajtim	Në pajtim

Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve lidhur me aftësinë teknike dhe / ose profesionale:

O.E. „DARDAX“ Ka dorëzuar katalogun e prodhuesit por i cili nuk plotëson specifikimin teknik në pikat si në vijim:

MASKA – Full Face Mask

Maska e maskës duhet të përbëhet nga dy shtresa izolimi të dyfishtë për të siguruar përshtatje të sigurt për të gjitha format e fytyrës

Maska duhet të ketë modelin e shiritit të kokës për të siguruar vendosje të shpejtë, të lehtë, të sigurtë izolim të sigurt dhe të rehatshëm dhe përshtatje të rehatshme të të gjitha formave të fytyrës

Sistemi i lidhjes me aparatet e frymërrjes - P

S-H AMBIENT AIR HATCH

1.Maska nuk posedon dy shtresa izolimi

2.Maska nuk posedon konektimin e kërkuar "P", posedon tjetër lloj konektimi M16

INFORMACIONET SHITESË TË MARRA ME ANË TË SQARIMEVE TË KERKUARA NGA E EKSPERTËVE SHQYRTUES DHE / OSE TEKNIK

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE "Fitim R. Bilalli B.I" - Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit **Furnizim me Aparate të Frymërrjes dhe Bombola të Ajërit** me nr. të prokurimit 21432700-22-3555-1-1-1., iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – AGJENCIA PER MENAGJIM EMERGJENT.

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP-së

(Të jepet një vlerësim se OE ankues është apo nuk është palë me interes sipas nenit 4.1.26).

VENDIMET E MËPARSHMETË PSH-së LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

Me date 03.11.2022 *Organi Shqyrtues I Prokurimit* nxjerr VENDIMIN me nr. PSH.nr.408/22 duke vendosur sipas ankeses se parashtruar nga operatori ekonomik "Fitim R.Bilalli"B.I, Prishtinë për aktivitetin e prokurimit : "Furnizim me Aparata të Frymarrjes dhe Bombola të Ajërit", me numër të prokurimit 21432700-22-3555-1-1-1që:

1. **Aprovohet** si e bazuar ankesa e "Fitim R.Bilalli"B.I, Prishtinë,e parashtrua ne Organin Shqyrtues te Prokurimit, me numër protokolli 408/22 për aktivitetin e prokurimit "Furnizim me Aparata të Frymarrjes dhe Bombola të Ajërit", me numër të prokurimit 21432700-22-3555-1-1-1 .
2. **Anulohet**, njoftimi i AK-se, për dhënie të kontratës të aktivitetit të prokurimit: "Furnizim me Aparata të Frymarrjes dhe Bombola të Ajërit", me numër të prokurimit 21432700-22-3555-1-1-1 dhe lënda kthehet ne RI-vlerësim.

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

(Të sqarohet për rastin se pse është devijuar nga praktika e mëparshme).

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES "Fitim R. Bilalli B.I" - PRISHTINË

Sqarim Hyrës:

Autoriteti Kontraktues, Agjencia për Menaxhim Emergjent (AME), gjate këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedure te hapur, lloji i kontratës: kontrate kornizë.

Pergjigje ne pretendimet e perseritura ankimore:

Pas shqyrtimit të ankesës kundrejt pretendimeve të përsëritura ankimore të "Fitim R. Bilalli B.I" janë te njëjtat mbi te cilat Organi Shqyrtues ka dhënë përgjigje me date 03.11.2022 me nr. PSH.nr.408/22:

- Sipas Raportit të Vlerësimit të tenderëve nga ana e Komisionit **nuk ka qenë i pajtueshëm apo përgjegjshëm**, për arsye ne katalogun e dorëzuar te prodhuesit i cili nuk i plotëson specifikimin teknik ne pikat:
 - 1. Maska nuk posedon dy shtresa izolimi
 - 2. Maska nuk posedon konektimin e kërkuar "P" por posedon tjetër lloj konektimi M16.

Sa i përket pretendimit nr.1 se Maska nuk posedon dy shtresa izolimi, kjo lehte vërehet dhe vërtetohet ne katalogun e vulosur dhe nënshkruar nga përfaqësuesi ku deklarojnë qe maska përbehet prej dy shtresave. Citojmë ne Anglisht: THE MASS OF MASK CONSIST OF TWO LAYERS OF DOUBLE INSULATION TO ENSURE A SECURE AND SAFE FIT FOR ALL FACIAL FORMS. Andaj ky pretendim është sqaruar

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE "Fitim R. Bilalli B.I" - Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit Furnizim me Aparate të Frymarrjes dhe Bombola të Ajërit" me nr. të prokurimit 21432700-22-3555-1-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – AGJENCIA PER MENAGJIM EMERGJENT.

Q.7

edhe ne raportin e pare te ekspertit si dhe ne Vendimin e OSHP-se nr. 408/22 si i pabazuar.

MASK - Full Face Mask - S Mask	
The mass of mask consists of two layers of double insulation to ensure a secure and safe fit for all facial forms	
The mask has the design of the headband to ensure quick, easy placement, provide safe and comfortable isolation and comfortable fit of all facial forms	
The material of the mask is:	
<ul style="list-style-type: none"> natural rubber 	
Sizes	3 sizes
The face mask is equipped with an integrated breathing valve, locked in the face mask	
The breathing valve does not come loose during operation.	
The face mask is equipped with an ambient air clip that enables the use of ambient air while in stand-by.	
Positive pressure activates	
<ul style="list-style-type: none"> manually (with a one-hand push on the exhalation valve cover), or automatically 	
The breathing valve is in the center or on any side of the mask, and it doesn't block the field of view.	
Tested in accordance with 89/686EEC standards EN 136:1998	
The connection system with breathing apparatus	P
Mask weight	550-800 gr
Approvals	EN 136 or EN 137:2008

Kristoffer Nilsson

Sales Manager Interspiro



- *Konsiderojë që Autoriteti Kontraktues nuk i ka plotësuar të gjitha kriteret mbi konkurrueshmërinë te vendosura në dosjen e tenderit, konform rregullave dhe Ligjit Nr. 04/L-042 per Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr.05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092,*
- *Neni 28 për Specifikimet teknike te tenderit, si dhe Neni 56 pika 2.2 mbi Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave:*
- *Neni 28 mbi Specifikimet teknike pika:*

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE "Fitim R. Bilalli B.I" - Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit **Furnizim me Aparate të Frymarrjes dhe Bombola të Ajërit** me nr. të prokurimit 21432700-22-3555-1-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – AGJENCIA PER MENAGJIM EMERGJENT.

9.7

- 2. Autoriteti kontraktues do t'i përpilojë specifikimet teknike në atë mënyrë që ato të jenë në përputhje me qëllimin e prokurimit dhe të drejtuara drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomik dhe tenderuesit. **Autoriteti kontraktues është veçanërisht i ndaluar që të hartojë specifikime teknike që favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomik. Dhe**
- 6. Nëse një tenderues mund të paraqet në tenderin e tij, përmes çfarëdo mase të duhur (siç janë, dosjet teknike ose raport testimi nga një palë e tretë e pavarur), se zgjidhja e propozuar nga tenderuesi në mënyrë ekuivalente plotëson kërkesat e definuara në specifikim teknik, autoriteti kontraktues nuk mund të refuzoj tenderin me arsyetimin se produkti ose shërbimi i ofruar nuk përputhet me specifikimet teknike të formuluar duke iu referuar ndonjë specifikimi të përmendur në paragrafin 4. dhe 5. të këtij neni.

7. Autoriteti kontraktues nuk do të përpilojë specifikimet teknike që i referohen një artikulli ose burimi të veçantë, ose një procesi të hollësishëm, **ose ndonjë shenje dalluese**, lloji ose origjine të veçantë ose ndonjë prodhimi. Pavarësisht nga e mësipërmja, autoriteti kontraktues mundet, që në kushte të jashtëzakonshme, të hartojë specifikime teknike ose të bëjë një referim të tillë të veçantë, nëse autoriteti kontraktues në mënyrë të qartë vërteton se, nuk është e mundur që të përpilojë një specifikim mjaft të saktë dhe të kuptueshëm të lëndës së kontratës përkatëse, në pajtim me paragrafin 3-6. të këtij neni ose ndryshe; me kusht që, çfarëdo referimi i tillë të shoqërohet me fjalët "ose ekuivalent"

Maska e fytyrës duhet të jetë e pajisur me një valvul të integruar të frymëmarrjes, të kyçur në maskën e fytyrës Valvula e frymëmarrjes nuk duhet të jetë e mundur të humbasë gjatë operacionit Maska e fytyrës duhet të jetë e pajisur me një kapëse të ajrit të ambientit që mundëson përdorimin e ajrit të ambientit ndërsa është në pritje.	
Presioni pozitiv duhet të aktivizohet <ul style="list-style-type: none"> • Manualisht (me një shtytje të njëres anë mbi kapakun e valvulës së nxjerrjes) • Automatikisht 	
Valvula e frymëmarrjes duhet të jetë në qendër ose në njërën anë të maskës dhe nuk duhet të bllokojë shikimin. Testuar në përputhje me standardet 89 / 686EEC, EN 136: 1998	
Sistemi i lidhjes me aparatet e frymëmarrjes	P
Pesha e maskës	550-800 gr
Aprovimet	EN 137 ose EN 137:2006

- Tek Dosja e tenderit ne fushën ku kërkohet **SISTEMI I LIDHJES ME APARATET E FRYMEMARRJES** vërehet qe është specifikuar lloji "P" si shenje dalluese, andaj konsideroj qe me këtë rast është ngushtuar konkurrenca dhe janë shkelur dispozitat e LLP-se Nenit 28 dhe pikat e lartë cekura, posaçërisht pika 6 e Nenit 28 ku thotë: Se nëse zgjidhja e propozuar nga tenderuesi në mënyrë ekuivalente plotëson kërkesat e definuara në specifikim teknik, autoriteti kontraktues nuk mund të refuzoj tenderin me arsyetimin se produkti ose shërbimi i ofruar nuk përputhet me specifikimet teknike të formuluar duke iu referuar ndonjë specifikimi të përmendur në paragrafin 4. dhe 5. të këtij neni.

Duke marre edhe për baze kërkesën për sqarim nga Operatori Ekonomik i propozuar për kontratë drejtuar Autoritetit Kontraktues i datës 16 Maj 2022 lidhur se "A mund te ofrohet maska pa kapësen e ajërit pasi qe këtë pike e plotëson vetëm një prodhues "Interspiro Air Hatch".

Netcom

Pyetje për: AGJENCIA PËR MENAGJIM EMERGJENT

Titulli: Furnizim me Aparate të Frymarrjes dhe Bombola të Ajërit
Numri i prokurimit: 21432700-22-3555-1-1-1

16 Maj 2022

1. Cilindri i Ajërit.

Aparati i frymarrjes përbehet nga katër komponente themelore që duhet të ketë peshë totale të lejuar 7.7 kg, duke u bazuar në specifikimin teknik.

A mund te ofrohet bombola me peshë 4.2 kg, meqen se komponentet tjera janë më të lehta se sa pesha maksimale e lejuar në specifikimin teknik qe në tanësi nuk e kalon peshen mbi 7.9 kg dhe nuk e kalon tolerancën mbi 2% të lejuar në DT?

2. Maska

A mund te ofrohet maska pa kapesën e ajërit, pasi qe këtë pike e plotëson vetëm një prodhues "Interspiro Air Hatch"? Funkcionin e kësaj kapëse mund të përbushin edhe prodhuesit tjerë duke liruuar automatikisht frymarrjes.

3. Kriteret

Për hirë të transparencës a mund të kerkohet nga ana e juaj qe të gjithë Operatorët Ekonomik "katalogun i pajisjeve i cili nuk përputhet me atë ne faqen zyrtare të prodhuesit" të konsiderohet si i manipuluar? Këtë kërkesë po e bëjmë pikerisht nga dyshimet që kemi pas në projektin në vitin 2020 "Furnizim me Aparata të Frymarrjes dhe Bombola të Ajërit" 21432700-20-4902-1-1-1.

Ne këtë mënyrë Autoriteti Kontraktues i përgjigjet qe: MASKA- ka mundësi qe te përdoren edhe sisteme te ngjashme dhe ekuivalente me te specifikuara ne DT-Aneksin ne.1. Ky sistem mundëson përdorimin e ajërit

te ambientit saher qe përdoruesit e aktivizojnë atë. Shih foton:

Autoriteti Kontraktues ne specifikim teknik tek Dosja e fenderi - tek MASK ka pasur kërkesën si vijon:

Madhesite	Min. 3 madhesi
Maska e fytyres duhet te jetë e pajisur me një valvul të integruar të frymëmarrjes, të kyçur në maskën e fytyrës. Valvula e frymëmarrjes nuk duhet të jetë e mundur të humbasë gjatë operacionit. Maska e fytyrës duhet të jetë e pajisur me një kapëse të ajrit të ambientit që mundëson përdorimin e ajrit të ambientit ndërsa është në prirje.	

Për këtë kërkesë ne specifikim teknik ka pasur kërkesë për sqarim dhe atë me pyetjen si në vijim:

MASKA – A mundet që të ofrohet maska pa kapësen e ajërimit, pasi që këtë pike e plotëson vetëm një prodhues „Interspiro Air Hatch” funksionin e kapëse mundën që ta plotësojnë edhe prodhues të tjerë duke liruuar automatikisht frymëmarrjes.

Autoriteti kontraktues konform LPP dhe pyetjes sqaruese me datën 18.05.2022 ka lëshuar përgjigjein si në vijim:

MASKA – Ka mundësi që të pordoren edhe sisteme të ngjajshme dhe ekuivalente me të specifikuarin në DT- Anëksin nr.1. Ky sistem mundëson pordorimin e ajërimit të ambientit saher qe pordoruesit e aktivizojnë këtë.

E që në këtë rast të përgjigjes AK ka pranuar që Mask që e ka sistemin e ngjajshëm për pordorim të ajërimit nga ambienti pa pasur nevojë që ta aktivizojë aparatit e frymëmarrjes. Autoriteti kontraktues në sqarimet e datës 18.05.2022 ka sqaruar edhe për peshën e Cilindrit, por Autoriteti kontraktues asnjëherë nuk ka pasur pyetje apo kërkesa për sqarime nga ana e OE-ve, lidhur me Sistemin i lidhjes me aparatet e frymëmarrjes – P. Dhe bazuar në këtë pretendim juaj se AK ka jepur sqarime për Sistemin i lidhjes me aparatet e frymëmarrjes – P, nuk qëndron (shih sqarimin e publikuar nga AK me datën 18.05.2022)

Lidhur me pretendimet se OE i rekomanduar nuk plotëson kriteret e specifikimit teknik jua sqarim se janë të pa qëndrueshme dhe të pa argumentuara ligjërisht dhe profesionalisht nga ana juaj. Po ashtu për sqarimin tuaj dhe të gjithë të interesuarve po ju shpalos katalogut për Maskën të ofruar nga ana e OE të rekomanduar që dëshmon se Maska ka Sistemin e lidhjes me aparatit e frymëmarrjes – „P” si dhe Fotot e mostres e cila dëshmon për Sistemin e lidhjes me aparatit e frymëmarrjes – P.

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i konsideron që pretendimet ankimore janë të përsëritura dhe se Organi Shqyrtues i Prokurimit e ka dhënë vendimin e tij me datë 03.11.2022 me nr.PSH.nr.408/22 ndaj këtyre pretendimeve. Duke aluduar edhe në faktet shtesë të lartë cekura, ankesa e OE “Fitim R. Bilalli” të aprovet si pjesërisht e bazuar, duke respektuar edhe Nenin 105 të LLP-se mbi Kompetencat e OSHP-së pika:

2.16. Në rastet e përsëritura me pretendimet e njëjta ankimore, kur objekti i kontestit dhe palët janë të njëjta, për raste të cilat janë shqyrtuar më parë, Kryetari i panelit shqyrtues duhet të trajtojë si çështje të gjykuar “res judicata”.

Raporti i eksperizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues
- Agjencia për Menagjimin Emergjent (AME)
- Panelit Shqyrtues
- OSHP.
- OE ankues
- Operativ Ekonomik “Fitim R. Bilalli B.I”.

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtuar nga OE “Fitim R. Bilalli B.I” - Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit Furnizim me Aparatet të Frymëmarrjes dhe Bombola të Ajërimit me nr. të prokurimit 21432700-22-3555-1-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – AGJENCIA PËR MENAGJIM EMERGJENT.

G.7